



REPubLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO  
KOMUNA E VUSHTRRISE-OPŠTINA VUÇITRN

01 Nr. / Br 239/24  
Nr. i fq. / Br. st - 17 -  
Data: / Datum 26. 12. 2024  
VUSHTRRI - VUÇITRN



REPUBLIKA E KOSOVËS

KUVENDI I KOMUNËS VUSHTRRI

---

**PLANI  
I PUNËS I KUVENDIT TË KOMUNËS SË VUSHTRRISE PËR  
VITIN 2025**

**Dhjetor, 2024**

## PËRMBAJTJA

<b>Hyrje.....</b>	<b>3</b>
<b>Qëllimi .....</b>	<b>5</b>
<b>Janar .....</b>	<b>6</b>
<b>Shkurt.....</b>	<b>7</b>
<b>Mars.....</b>	<b>8</b>
<b>Prill .....</b>	<b>9</b>
<b>Maj.....</b>	<b>10</b>
<b>Qershor.....</b>	<b>11</b>
<b>Korrik.....</b>	<b>12</b>
<b>Gusht .....</b>	<b>13</b>
<b>Shtator .....</b>	<b>14</b>
<b>Tetor .....</b>	<b>15</b>
<b>Nëntor .....</b>	<b>16</b>
<b>Dhjetor.....</b>	<b>17</b>

## HYRJJE

Kuvendi i Komunës është organi më i lartë në komunë dhe zgjedhet drejtpërdrejt nga qytetarët, si dhe funksionon në bazë të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (LVL), Statutit të Komunës dhe akteve tjera nënligjore.

Kuvendi i komunës nuk i delegon përgjegjësitë e tij lidhur me marrjen e vendimeve për:

- Statutin dhe rregulloren e punës, rregulloret komunale, miratimin, ndryshimin dhe shfuqizimin e tyre;
- miratimin e buxhetit dhe planeve investuese;
- miratimin e çështjeve të tjera financiare, të cilat janë të rezervuara për kuvendin sipas statutit apo rregullores së punës;
- planin vjetor të punës dhe raportin vjetor;
- themelimin e komisioneve të kërkuara sipas këtij ligji;
- zgjedhjen e kryetarit dhe zëvendëskryetarit të komunës;
- nivelin e tarifave dhe ngarkesave;
- krijimin dhe përdorimin e simboleve, dekoratave dhe titujve të nderit të komunës, në pajtim me ligjin në fuqi;
- emërtimin dhe riemërtimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve tjera publike;
- arritjen e marrëveshjeve ndërkomunale dhe brendakomunale;
- marrjen e vendimeve për t'u bashkuar me asociacione përfaqësuese të komunave të Republikës së Kosovës;
- përgjegjësi të tjera që kërkojnë me ligj.

Për marrjen e vendimeve, Kuvendi i komunës mund t'ia delegojë pushtetin e tij Komitetit për Politikë dhe Financa apo Kryetarit të komunës. Kuvendi i komunës mund të tërheqë delegimin në çdo kohë.

Komiteti për Politikë dhe Financa (KPF) është përgjegjës për shqyrtimin e të gjitha politikave, dokumenteve fiskale dhe financiare, planeve dhe iniciativave, duke përfshirë dokumentet e planifikimit strategjik, Kornizën vjetore buxhetore afatmesme, Planin vjetor të prokurimit, Rregulloren vjetore për tatimet, tarifrat dhe pagesat, Planin vjetor të punës për auditimin e brendshëm, buxhetin vjetor afatmesëm dhe çdo ndryshim të buxhetit gjatë vitit fiskal, për marrjen e raporteve nga kryetari, si dhe dorëzimin e rekomandimeve në Kuvendin e komunës.

Kuvendi i komunës siguron kushte të punës për mbajtje të mbledhjeve të Kuvendit të komunës, krijon hapësirë për pjesëmarrjen e qytetarëve gjatë mbledhjeve, siguron transparencë të plotë ndaj qytetarëve për të gjitha vendimet dhe aktet, si dhe për çdo gjë që është në interes të qytetarëve. Po ashtu, iu krijon mundësi qytetarëve që përmes formave të ndryshme të jenë pjesëmarrës në vendimmarrje.

Përveç këtyre akteve, Kuvendi i komunës kryen edhe aktivitete tjera që janë të domosdoshme për realizimin e përgjegjësisë së tij, përfshirë edhe funksione tjera, detyra dhe përgjegjësi të padeleguara si:

- Vendimet që kanë të bëjnë me pronën e komunës;
- Miratimin e Planit Zhvillimor Komunal (PZHK);
- Miratimin e Planeve Strategjike të Zhvillimit Ekonomik Lokal, etj.

Plani i Punës i Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë është dokument i mbështetur në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, Statutin e Komunës, Rregulloren për Punën e Kuvendit dhe Organeve të Tij dhe akteve tjera nënligjore. Plani është i hartuar në bazë të një kornize logjike, i cili planifikon etapa të realizimit të punëve dhe detyrave të kuvendit, të bazuara në përgjegjësitë që dalin nga legjislacioni në fuqi.

Me këtë plan synohet arritja e objektivave për vitin 2025, ku Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë planifikon t'i mbajë njëmbëdhjetë (11) mbledhje të rregullta, gjashtë prej të cilave në gjashtëmujorin e parë të vitit 2025, në të cilat do të trajtohen çështjet që janë në interes të komunës dhe të qytetarëve të saj. Përveç tjerash, Kuvendi i komunës trajton edhe këto çështje:

- Miraton buxhetin, planet investuese, planin vjetor të prokurimit;
- Miraton çështjet tjera financiare, të cilat janë të rezervuara për Kuvendin, sipas statutit apo rregulloreve të punës;
- Nxjerr rregullore dhe bën harmonizimin e rregulloreve ekzistuese, sipas ligjeve në fuqi;
- Themelon komitetet këshillëdhënëse dhe trupa tjera ad-hoc sipas nevojës;
- Planifikon shqyrtimin e raporteve të rregullta të punës së Kryetarit të komunës sipas ligjit;
- Organizon takime buxhetore me qytetarë, lidhur me planifikimin e buxhetit të komunës;
- Mbikëqyr, diskuton, analizon dhe vlerëson punën e ekzekutivit komunal.

## QËLLIMI

Plani vjetor i punës i Kuvendit të komunës ka për qëllim që t'i ndihmojë dhe lehtësojë punimet e mbledhjeve të Kuvendit, duke ju ofruar anëtarëve të Kuvendit këtë plan, në ç'rast ata do ta kenë një pasqyrë për punët dhe aktivitetet e parapara për vitin 2025, e që kanë të bëjnë me interesat e qytetarëve.

Me këtë plan janë paraparë njëmbëdhjetë (11) mbledhje të rregullta, por sipas nevojës mund të mbahen edhe mbledhje të tjera, përfshirë mbledhjet e jashtëzakonshme, urgjente, solemne, siç parashihen me Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale, Statutin e Komunës, Udhëzimin Administrativ për Mbajtjen e Mbledhjeve të Kuvendit të Komunës.

Dinamika e Planit të Kuvendit të Komunës së Vushtrisë do të realizohet në bazë të orarit të mbledhjeve të Kuvendit, të miratuara në mbledhjen e parë të Kuvendit në vitin 2025.

Kryesuesja e Kuvendit mund të mbajë takime mujore ose sipas nevojës me shefat e grupeve kuvendare të subjekteve politike të përfaqësuara në kuvend, me qëllim të bashkërendimit të punës së Kuvendit.

Për përmbushjen e planit të punës, ekzekutivi ju ofron mbështetje profesionale dhe administrative organeve të kuvendit, duke përshtatur organizimin e brendshëm për realizimin e objektivave dhe agjendës, sipas këtij plani.

Për mbarëvajtjen e zbatimit të të gjitha aktiviteteve sipas dinamikës, të përcaktuara me këtë plan do të përkujdesen: Kryetari i komunës, Kryesuesja e Kuvendit dhe Sekretaria e Kuvendit.

Realizimi i Planit të Punës të Kuvendit, kërkon bashkërenditje dhe koordinim të aktiviteteve me ekzekutivin e komunës, i cili duhet t'i përmbahet Planit të Kuvendit për vitin 2025.

Plani i Punës i Kuvendit sipas dinamikës mujore përfshin: emërtimin e aktit, propozuesin, afatin e dërgimit nga propozuesi, afatet e shqyrtimeve nga Kuvendi.

**PLANI  
I PUNËS I KUVENDIT TË KOMUNËS SË VUSHTRRISË PËR VITIN 2025**

**JANAR**

Nr.	AKTIVITETET	ORGANI PËRGJEGJËS		AFATI I PROCEDIMIT
1.	Raport vjetor për të hyrat dhe shpenzimet buxhetore për vitin 2024	Kryetari i komunës	Drejtoria për Buxhet dhe Financa	3.1.2025
2.	Të ndryshme			3.1.2025

**SHKURT**

Nr.	AKTIVITETET	ORGANI PËRGJEGJËS		AFATI I PROCEDIMIT
1.	Informatë për shërbimet shëndetësore për vitin 2024 në Komunën e Vushtrrisë	Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale		3.2.2025
2.	Informatë për gjendjen e sigurisë në Komunën e Vushtrrisë për vitin 2024	Komandanti i stacionit policor në Vushtri		3.2.2025
3.	Informatë për punën e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2024	Kryetari i komunës		3.2.2025
4.	Raport për punën njëvjeçare të Komitetit për Komunitete për vitin 2024	Komiteti për Komunitete		3.2.2025
5.	Informatë lidhur me procedurën e kërkesave për lejet ndërtimore për vitin 2024	Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit		3.2.2025
6.	Të ndryshme			3.2.2025

MARS

Nr.	AKTIVITETET	ORGANI PËRGJEGJËS		AFATI I PROCEDIMIT
1.	Raport për situatën ekonomiko - financiare dhe zbatimin e planeve investuese për vitin 2024	Kryetari i komunës		3.3.2025
2.	Bartja e të hyrave vetanake nga viti 2024 në vitin 2025	Drejtoria për Buxhet dhe Financa		3.3.2025
3.	Informatë për përfundimin e gjysmëvjetorit të parë të vitit shkollor 2024/2025	Drejtoria për Arsim		3.3.2025
4.	Informatë lidhur me ndërtimet në Komunën e Vushtrrisë për vitin 2024	Drejtoria për Inspektime		3.3.2025
5.	Informatë lidhur me ofrimin e shërbimeve nga Drejtoria për Administratë për vitin 2024	Drejtoria për Administratë		3.3.2025
6.	Raport për punën e NPL “Përparimi” në Vushtri për vitin 2024	Komisioni i aksionarëve		3.3.2025
7.	Të ndryshme			3.3.2025

**PRILL**

Nr.	AKTIVITETET	ORGANI PËRGJEGJËS		AFATI I PROCEDIMIT
1.	Raport tremujor për të hyrat dhe shpenzimet buxhetore	Kryetari i komunës	Drejtoria për Buxhet dhe Financa	2.4.2025
2.	Raport i Komisionit të aksionarëve i Ndërmarrjes regjionale për menaxhimin e mbeturinave “Uniteti” për vitin 2024	Drejtoria për Shërbime Publike, Komisioni i aksionarëve		2.4.2025
3.	Informatë e punës së Ndërmarrjes regjionale ujësjellësi “Mitrovica” për vitin 2024	Drejtoria për Shërbime Publike		2.4.2025
4.	Rishikimi i Planit të veprimit për të gjeturat e auditorit të përgjithshëm	Drejtoria për Buxhet dhe Financa		2.4.2025
5.	Të ndryshme			2.4.2025

**MAJ**

Nr.	AKTIVITETET	ORGANI PËRGJEGJËS		AFATI I PROCEDIMIT
1.	<b>Propozim- vendim për ndarjen e dekoratave dhe mirënjohjeve për Ditën e Çlirimit</b>	<b>Komisioni për ndarjen e mirënjohjeve dhe dekoratave</b>		<b>2.5.2025</b>
2.	<b>Informatë lidhur me Qarkoren buxhetore 2026 dhe miratimi i Planit të veprimit për dëgjimet publike</b>	<b>Drejtoria për Buxhet dhe Financa</b>		<b>2.5.2025</b>
3.	<b>Të ndryshme</b>			<b>2.5.2025</b>

**QERSHOR**

Nr.	AKTIVITETET	ORGANI PËRGJEGJËS		AFATI I PROCEDIMIT
1.	Draft - Korniza Afatmesme (KAB) për vitet 2026-2028	Drejtoria për Buxhet dhe Financa		2.6.2025
2.	Informatë për shfrytëzimin e pasurisë jo financiare të komunës për vitin 2024	Kryetari i komunës	Drejtoria për Buxhet dhe Financa	2.6.2025
3.	Informatë rreth procedurës së legalizimit të objekteve pa leje për vitin 2024	Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit		2.6.2025
4.	Të ndryshme			2.6.2025

**KORRIK**

Nr.	AKTIVITETET	ORGANI PËRGJEGJËS		AFATI I PROCEDIMIT
1.	Informatë lidhur me zbatimin e vendimeve të Kuvendit të komunës, për periudhën janar-qershor 2025	Kryetari i komunës		3.7.2025
2.	Raport gjashtëmuor për të hyrat dhe shpenzimet buxhetore për periudhën janar-qershor 2025	Kryetari i komunës	Drejtoria për Buxhet dhe Financa	3.7.2025
3.	Pasqyrat financiare për vitin 2024 dhe raporti i auditorit të përgjithshëm	Kryetari i komunës	Drejtoria për Buxhet dhe Financa	3.7.2025
4.	Informatë për ndarjen e bursave dhe shpërblimet e nxënësve për vitin 2024/2025	Drejtoria për Arsim		3.7.2025
5.	Informatë lidhur me mbrojtjen e mjedisit	Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit		3.7.2025
6.	Të ndryshme			3.7.2025

# **GUSHT**

**MUAJ I PUSHIMEVE**

**SHTATOR**

Nr.	AKTIVITETET	ORGANI PËRGJEGJËS		AFATI I PROCEDIMIT
1.	Shqyrtimi i draft- buxhetit dhe planeve investuese për vitin 2026	Kryetari i komunës		2.9.2025
2.	Raporti i sistemit për matjen e performancës në ofrimin e shërbimeve komunale	Koordinatori për performancë i Komunës së Vushtrrisë		2.9.2025
3.	Raport për situatën ekonomiko - financiare dhe zbatimin e planeve investuese, për periudhën janar-qershor 2025	Kryetari i komunës		2.9.2025
4.	Informatë për përfundimin e korrje-shirjeve dhe përgatitjet për mbjelljet vjeshtore	Drejtorja për Bujqësi dhe Zhvillim Rural		2.9.2025
5.	Rishikimi i Planit të veprimit për të gjeturat e auditorit	Drejtorja për Buxhet dhe Financa		2.9.2025
6.	Të ndryshme			2.9.2025

**TETOR**

Nr.	AKTIVITETET	ORGANI PËRGJEGJËS		AFATI I PROCEDIMIT
1.	Raport nëntëmujor për të hyrat dhe shpenzimet buxhetore	Kryetari i komunës	Drejtoria për Buxhet dhe Financa	3.10.2025
2.	Informatë për furnizimin me ujë të pijes në territorin e Komunës së Vushtrrisë	Drejtoria për Shërbime Publike		3.10.2025
3.	Informatë nëntëmujore për punën e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport	Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport		3.10.2025
4.	Propozim – vendim për formim të komisionit për hartimin e Draft - Planit të punës së Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë për vitin 2026	Kryesuesja e Kuvendit		3.10.2025
5.	Të ndryshme			3.10.2025

**NËNTOR**

Nr.	AKTIVITETET	ORGANI PËRGJEGJËS		AFATI I PROCEDIMIT
1.	Propozim - Vendim për caktimin e normave tatimore për vitin 2026	Drejtoria për Buxhet dhe Financa		3.11.2025
2.	Informatë për punën e Drejtorisë për Ekonomi, dhe Investime Kapitale	Drejtoria për Ekonomi, dhe Investime Kapitale		3.11.2025
3.	Informatë për përfundimin e vitit shkollor 2024/2025 dhe përgatitjet për fillimin e vitit shkollor 2025/2026.	Drejtoria për Arsim		3.11.2025
4.	Informatë lidhur me zbatimin e Planit zhvillimor komunal	Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit		3.11.2025
5.	Informatë për menaxhimin e mbeturinave në territorin e Komunës së Vushtrrisë	Drejtoria për Shërbime Publike		3.11.2025
6.	Informatë lidhur me rezultatet (ecurinë) e dhënies në shfrytëzim të tokave bujqësore	Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë		3.11.2025
7.	Të ndryshme			3.11.2025

**DHJETOR**

Nr.	AKTIVITETET	ORGANI PËRGJEGJËS		AFATI I PROCEDIMIT
1.	Draft-Plani i punës së Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë për vitin 2026	Kryesuesja e Kuvendit		03.12.2025
2.	Draft-Plani i punës i Kryetarit të komunës për vitin 2026	Kryetari i Komunës		03.12.2025
3.	Propozim-vendim për publikimin e listës së Pronave të paluajtshme të Komunës së Vushtrrisë për dhënien në shfrytëzim për vitin 2026	Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë		03.12.2025
4.	Informatë për shërbimet sociale dhe të asistencës në Komunën e Vushtrrisë për periudhën janar-nëntor 2025	Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale		03.12.2025
5.	Informatë nga Njësia e Zjarrfikësve për periudhën janar-nëntor 2025	Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim	Njësia e Zjarrfikësve	03.12.2025
6.	Të ndryshme			03.12.2025


**Melihate Basholli-Latifi**  
 Kryesuese e Kuvendit